



VENDIM

Nr. 56 Datë 03.08.2009

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË RREGULLAT E TREGUT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s dhe, vendimit Nr. 68, datë 23.06.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për Miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, pika XIX.1.1, vendimit nr. 39, datë 18.05.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për disa ndryshime dhe shtesa në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03.08.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga OST sh.a për ndërhyrjen në dispozitat e Rregullave të Tregut që lidhen me rregullat për alokimin e kapacitetit të interkonjeksionit,

Vendosi :

1. Në Rregullat e Tregut Shqiptar të energjisë elektrike të miratuar me Vendimin nr.68, datë 23.06.2008, të behen keto ndryshime dhe shtesa si më poshte:

Pika X.1.2, riformulohet:

“Te drejtat e siguruara – OST-ja do t’i rezervoje nje kapacitet specifik prej 25% Furnizuesit Publik me Shumice dhe prej 50% per OSSH.

Keto te drejta te siguruara per interkonjeksioni jane vetem per importin. Kerkesat per kapacitet interkoneksioni per qellim tranzitimi do te merren ne konsiderate nga ana e OST-se, vetem mbas plotesimit te kerkesave per importin e energjise elektrike per nevojat e konsumatoreve tarifore dhe atyre te kualifikuar si dhe mbulimin e humbjeve ne Sistemin e Shperndarjes.

ERE mund te rishikojë dhe modifikojë te drejtat e siguruara sipas ketij paragrafi brenda muajit nentor te cdo viti.”

Ne Piken X.1.3 fjalia “Te drejtat ndahen per cdo Interkoneksion si per importin ashtu edhe per eksportin dhe gjithashtu mund te tregtohen mes pjesemarrësve”, ndryshohet si vijon:

“Te drejtat e interkoneksionit mund te tregtohen mes pjesemarrësve.”

2. Ngarkohen Pjesëmarrësit e Tregut per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 56 Datë 03.08.2009

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË RREGULLAT E TREGUT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____